



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2008/14, për z. Sabedin Vishi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2008/14, për z. Sabedin Vishi – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.T.P. “Dini”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarit të lartë z. Vishi, së pari i është bërë shkresa zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për njoftimin e fillimit të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së Konfliktit të Interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, ai është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet me ç' rast atij i janë dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

z. Vishi, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të autorizuar një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin e tij privat, dhe ka deklaruar se këtë do ta bëj brenda afatit të lejuar ligjor.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjencinë kundër Korrupsionit shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2606/14) me të cilën dëshmohej se ka

autorizuar një person të besueshëm për të menaxhuar biznesin privat N.T.P. "Dini". Me këto ndryshime, zyrtari i lartë z. Sabedin Vishi, ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

